

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e moduleve të lodrave”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
37500000-3 Lojra dhe lodra; zbavitëse në natyrë**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,082,850 (dy milion e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2 dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht në vlerën:41,657 (dyzet e njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare, nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer në numrin e llogarise së Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kriteri që operatori ekonomik duhet të disponojë Certificate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që operatorët ekonomik disponojnë një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë të mallrave për të cilat ofertojnë.

Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoriteteve në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogelimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues në rastin kur është prodhues duhet të paraqesë Certifikatat e sigurisë dhe të përdorimit të pajisjeve në ambjentet e jashtme dhe të sigurta në përdorim sipas normave Europiane **S SH EN: 1176-1: 2017 (ose ekuivalente)**. Në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë këtë certifikatë nga prodhuesi.

Argumentimi: Certifikata **S SH EN: 1176-1: 2017 (ose ekuivalente)** specifikon kërkesat e përgjithshme të sigurisë për pajisjet e parkut të lojërave publike të instaluar në mënyrë të përhershme dhe sipërfaqet. Kërkesat shitesë të sigurisë për pjesë të veçanta të pajisjeve të këndit të lojërave janë të specifikuar sipas këtij standardi. **S SH EN: 1176-1: 2017** mbulon pajisjet e këndit të lojërave për të gjithë fëmijët. Ky standart është përgatitur me njohjen e plotë të nevojës për mbikëqyrje të fëmijëve të vegjël dhe të fëmijëve më pak të aftë ose më pak kompetent. Qëllimi i këtij standardi është të sigurojë një nivel të duhur sigurie kur luhet në, mbi ose rreth pajisjeve të këndit të lojërave, dhe në të njëjtën kohë të promovojë aktivitete dhe veçori të njohura për përfitimin e fëmijëve. Kjo pjesë e EN 1176 është e zbatueshme për pajisjet e këndit të lojërave të destinuar për përdorim individual dhe kolektiv nga fëmijët. Ai zbatohet gjithashtu për pajisjet dhe njësitë e instaluar si pajisje për kënd lojërash për fëmijë, megjithëse ato nuk janë prodhuar si të tilla.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllëgaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

- 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*
- 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*
 - c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;*
- 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;*

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

- 1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*
 - a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;*
 - b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.*
 - 2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*
 - a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;*
 - b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.*
- Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklaratat e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklaratat vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.
- Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2023,2024,2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore dhe të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara ndaj shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë (UKT).

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore si dhe shlyerjen e detyrimeve të maturuara ndaj shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë (UKT). , do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **deklaratë nga administratori i shoqërisë ku të deklarojë se materialet janë të reja, të papërdorura, pa defekte dhe sipas sasisë dhe specifikave teknike të përshkruara nga autoriteti kontraktor.**

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin materiale të reja konform specifikimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë **Autorizim nga Prodhuesi** ose distributor i autorizuar prej tij, i cili merr përsipër të furnizojë ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit (nëse autorizimi nuk është në gjuhën shqipe, atëherë duhet të jetë i përkthyer dhe i noterizuar).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41, pika 6, nenin 44, pika 1 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik zotëron kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për zbatimin me korrektësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, vlerësohet e nevojshme që operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë me mallin e nevojshëm për realizimin e kësaj procedure prokurimi. Nisur nga fakti që materialet për mirëmbajtjen e moduleve të lodrave duhet të ketë cilësi shumë të mirë në prodhim me qëllim që të rezistojë sa më mirë kushteve atmosferike, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tij është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga furnizimi që parashikohet të realizohet si dhe për shkak të garantimit dhe rritjes së sigurtisë në objektet që ky mall do të përdoret duhet që mallrat objekt prokurimi të jenë sipas standarteve më të mira dhe njëkohësisht të sigurohet autoriteti kontraktor që OE fitues potencial ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke vënë në dispozicion të realizimit të kontratës brenda kohës së përcaktuar vetëm mallra origjinale dhe me garanci. Plotësimi i kërkesës më sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.4 Operatori ekonomik ne ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor duhet të paraqesë nga 1 mostër për zerat objekt prokurimi si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Aksesor druri për lodër Sustë (<i>trupë lodrës me pjesë të bashkuar</i>)	copë	1
2	Ndenjëse për kolovajse/lekundëse	copë	1
3	Ndenjëse për module Force	copë	1
4	Sustë metalike për module	copë	1
5	Shtyllë metalike për kosha Basketbolli	copë	1
6	Rreth metalik për kosh Basketbolli (<i>profesional</i>)	copë	1
7	Tapë e shesht në formë kapuçi (<i>plastike</i>)	set	1
8	Tapë për mbulimin e bulonave (<i>plastike</i>)	set	1

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet specifikisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK . Autoriteti kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike nëpërmjet paraqitjes së mostrave krijon mundësinë e kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim), të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruara në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Ky kriter konsiderohet i nevojshëm dhe i rëndësishëm për vlerësimin e ofertës teknike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të përgatitura nga specialistë të fushës si më poshtë:

- 1 **Rrëshkitëse plastike 'Polietilen' (vogël):** lartësia 100 cm dhe gjatësia 250 cm, material 'Polietilen'.
- 2 **Aksesor druri për lodër Sustë (trupi lodrës me pjesë të bashkuar):** material 'Playwood, me trashësi 21mm, rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe i lyer me ngjyrë.
- 3 **Ndenjëse për lishars në formë koshi (me mbrojtëse):** material plastik 'polietilen', me mbrojtëse në pjesën e përparme dhe zinxhir (çift) metali të zinguar 6mm, dimensione 55x45x25cm.
- 4 **Ndenjëse për lishars e sheshtë (drejtëkëndore):** material gome me përforcues metalik brenda saj, dimensione 30x50cm.
- 5 **Ndenjëse për kolovajse/lëkundëse:** material 'Fiber Glass' dhe poliester, me trashësi 20mm dhe dimensione 370x280mm.
- 6 **Ndenjëse me dorezë mbajtëse për kolovajse me bosht cilindrik:** material plastik, me dimensione 50x18x30cm, me bazament të harkuar për struktura në form tubi-90mm.
- 7 **Ndenjëse për module Force:** Material 'HDPE' rezistent ndaj kushteve atmosferike, me dimensione 40x30cm.
- 8 **Sustë metalike për module:** Susta metalike me diametër 200 mm, trashësi 20 mm dhe lartësi 400 mm, e trajtuar me ngjyrë të plastifikuar për metal dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike.
- 9 **Mbrojtëse plastike për ulëse kosh të lisharsit:** me forma të ndryshme, në dy anësorët me hapësira unazore për kalimin e zinxhirëve, dimensione 45x15x5cm.
- 10 **Doreza mbajtëse për lodra:** material plastik HDPE bashkë me tapat që mbulojnë vidën, me trashësi 35 mm dhe gjatësi 120 mm, në mes me hapësirë për shufër metalike 10x210mm.
- 11 **Doreza në formë trekëndore për lodra me varje:** doreza mbajtëse për lodra me ngjitje me duar, material plastik, dimensionet e dorezës 15x1,5x14cm.
- 12 **Ndalues gome për kolovajse:** material gome, për amortizimin e goditjes së kolovajses me tokën, element në form unaze dhe me pika anësore për kapjen në tokë.
- 13 **Shtyllë metalike për kosha Basketbolli:** Materiali çelik me seksione 2700x650mm (lartësi totale: 3350mm), shtylla metalike me dimensione 150x150x4mm, pjesa fundore e saj të ketë pllakat metalike 350x350x10mm, shtylla duhet të jetë e mbrojtur dhe e trajtuar me ngjyrë poliesteri (ngj.Kuqe ose Blu). Montimi shtyllës në tokë me ankerim metalik i parafabrikuar 350x350x4mm.
- 14 **Rreth metalik për kosh Basketbolli (profesional):** material hekuri i trajtuar me bojë rezistente ndaj

kushteve atmosferike, bazament katror '15x18cm dhe drejtëkëndor '23x13cm, me susta për amortizimin e goditjeve gjatë përdorimit, unaza me 12 pika lidhje të rrjetës.

15 **Rërë Gome** (*granulat gome 'SBR*): për mbushje të tapetit barit artificial për fusha futbollit dhe kalçeto, 1.5-3mm.

16 **Tapë e sheshtë në formë kapuçi** (*plastike*): për mbulimin fundor të binarëve të drurit me diametër 120 mm.

17 **Tapë për mbulimin e bulonave** (*plastike*): për mbulimin e bulona/dado të ndryshme, me bazament form rronde dhe tapë.

18 **Tapë për mbulim fundor të tubave lodra'160** (*plastike*): për mbulimin fundor të tubave metalik, për tuba me diametër të jashtëm '160 mm.

19 **Tapë për mbulim fundor të tubave lodra'130** (*plastike*): për mbulimin fundor të tubave metalik, për tuba me diametër të jashtëm '130 mm.

20 **Tapë për mbulim fundor të tubave lodra'110** (*plastike*): për mbulimin fundor të tubave metalik, për tuba me diametër të jashtëm '110 mm.

21 **Tapë për mbulim fundor të tubave lodra'80** (*plastike*): për mbulimin fundor të tubave metalik, për tuba me diametër të jashtëm '80 mm.

22 **Tapë për mbulim fundor të tubave lodra'60** (*plastike*): për mbulimin fundor të tubave metalik, për tuba me diametër të jashtëm '60 mm.

23 **Ngjitës për shtresa me gome dhe bar artificial**: përbërja dy komponentesh, me bazë 'Poliuretan'.

24 **Ristela dërrase për 'urën e lodrave, '40x100mmx1000mm** (*aksesor për lodra*): të përpunuara dhe trajtuara me shtresë boje mbrojtëse ndaj kushteve atmosferike.

25 **Ristela dërrase për 'shkallët e lodrave, '40x150x1000mm** (*aksesor për lodra*): të trajtuara me shtresë boje mbrojtëse ndaj kushteve atmosferike.

26 **Panele dërrase 'OSB' (fibër industriale) '15mm**: e trajtuar me mbrojtje ndaj kushteve atmosferike, përdoren për modulet lodra dhe element të terreneve sportive.

NJESIA E PROKURIMIT

Ledjana Harizi

Lindita Lika

Nevin Hëna